



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

**A.C.nr.3910/2018**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi, kryetar i kolegjit, Nehat Idrizi dhe Burim Shala – anëtarë të kolegjit, në çështjen kontestimore të paditëses D.N.P, me vendbanim në Rr. “...” nr...., Komuna Prishtinë, kundër të paditures Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, Komuna Prishtinë, të cilën e përfaqëson H.I, jurist pranë të paditurës, në çështjen kontestimore për shkak të kompensimit të diferencës së pagës, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, C.nr.2275/17 datë 08.05.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 15.02.2021, mori këtë :

### **A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET e pathemeltë** ankesa e të paditurës Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës me seli në Komuna Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2275/17 datë 08.05.2018, **VËRTETOHET**.

### **A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, me Aktgjykimin e ankimuar, C.nr.2275/17 datë 08.05.2018, ndër të tjera ka vendosur si vijon : *“...I.APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditëses D.N.P nga Prishtina, Rruga “B.Curri” nr.14 dhe Detyrohet e paditura që paditëses në emër të fitimit të humbur në nivel të diferencës neto në pagë për periudhën 01.02.2013 deri më datë 31.12.2014 t’ia paguajë vlerën neto prej 4.040,21€ dhe përveç kësaj shume obligohet e paditura që në trustin për sigurim pensional t’i paguaj paditëses kompenzimin për shumën e pa paguar prej 472.50€ dhe kompensimin për tatim në këtë diferencë në pagë në shumë prej 448,91€, e që bruto i bie të jetë shuma prej 4.333,65€ si dhe shpenzimet e procedurës në vlerë prej 181€, në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë...”*

Kundër Aktgjykimit C.nr.2275/17 datë 08.05.2018, të marrë nga Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, në afat ligjor përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës, me datë 11.06.2018, ka paraqitur ankesë, për shkak të: *shkeljeve qenësore të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale dhe vendimit për shpenzimet e procedurës*, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj si të bazuar ankesën ashtu që aktgjykimi i atakuar të ndryshohet ose të priset dhe çështja të rishqyrtim dhe vendosje.

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Gjykata e Apelit në seancën e kolegjit, në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, e ekzaminojë aktgjykimin e shkallës së parë brenda kufijve dhe shkaqeve të treguara në ankesë si dhe duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore dhe gjeti se:

***-Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.***

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësja D.N.P, ka paraqitur padi në Gjykatën e shkallës së parë me datë 11.05.2012, kundër të paditurit Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës me seli në Komuna Prishtinë, duke kërkuar kompensimin e diferencës së pagës.

Përgjigje në padi është paraqitur me datë 21.12.2012, me të cilën e paditura ndër të tjera ka deklaruar se: *"...e paditura e konteston në tërësi si të pa bazuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, ngase Aktvendimi mbi caktimin e lartësisë së të ardhurave personale paditëses, nr.01 – 1040 – 493/2012 i dt.07.03.2012, është vendim ligjor dhe në harmoni të plotë me kompetencat dhe autorizimet e punëdhënësit – Kryeshëfit Ekzekutiv dhe në harmoni të plotë me vendimin e aksionarit – Qeveria e Republikës së Kosovës ..."*

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin C.nr.1138/12 datë 03.11.2014 e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar.

Kundër këtij aktgjykimi ka parashtuar ankesë e paditura.

Gjykata e Apelit e Kosovës me Aktgjykimin AC.nr.1581/2015 datë 23.08.2017, e ka refuzuar ankesën e të paditurës si të pa bazuar në pjesën që ka të bëjë me anulimin e aktvendimit të të paditurës, ndërsa për një pjesë të padisë së paditëses e ka kthyer çështjen kontestimore në procedim të serishëm.

Gjykata e shkallës së parë, në procedim të serishëm e ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor me datë 08.05.2018, dhe pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor dhe administrimit të provave, ka marrë Aktgjykimin C.nr.2275/17 datë 08.05.2018, me të cilin e ka aprovuar në tërësi të bazuar kërkesëpadinë e paditëses duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit të atakuar ndër të tjera e ka arsyetuar se: *"...Kërkesëpadija e paditëses është e bazuar sepse paditësja dhe e paditura raportin e tyre punëdhënës – punëmarrës e kanë rregulluar me kontratë duke*

*përcaktuar të drejta dhe detyrime reciproke në mes tyre. Gjykata vlerëson se kontrata është në harmoni të plotë me dispozitat e Ligjit të Punës përkatësisht me dispozitat e nenit 11 të Ligjit të Punës. Me dispozitat e nenit 11.1.11 kontrata e punës duhet të përmbaj "lartësinë e pagës bazë, si dhe ndonjë shtesë ose të ardhur tjetër", në rastin konkret palët përkatësisht me nenin 5 të kontratës kanë përcaktuar se të punësuarit – paditësit i caktohet paga bazë për punën të cilën e kryen për punëdhënësin në lartësi të gradës 11 deri në momentin e lidhjes së kontratës së re me datë 31.12.2014... Kushtet e Kontratës të lidhur në mes paditësit dhe të paditurës duke përfshirë edhe lartësinë e pagës përkatësisht gradën sipas së cilës do të paguhet paga e paditësit janë në harmoni të plotë me dispozitat e Ligjit të Punës...".*

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Pretendimi ankimor i të paditurës se aktgjykimi i atakuar është marrë me shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së, nga se, sipas të paditurës dispozitivi i aktgjykimit është i pa kuptimtë dhe në kundërshtim me arsyet e dhëna, përkatësisht nuk përmban arsyeje të mjaftueshme për faktet relevante, e gjithashtu për faktet relevante ekzistojnë kundërthënie në mes të asaj se çka thuhet në arsyet e aktgjykimit mbi përmbajtjen e shkresave dhe procesverbaleve lidhur me deklaratat e dhëna gjatë procedurës, për Gjykatën e Apelit është pretendim i pathemeltë.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i Aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e Aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar, në përputhje të plotë me përmbajtjen e kërkuar me dispozitat e nenit 160 të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsyeje të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat duke i kualifikuar në pajtim me normat materiale juridike, ka nxjerrë përfundimin e drejtë për vendosje meritore.

E drejta materiale është aplikuar në mënyrë të drejtë dhe në raport me gjendjen faktike të vërtetuar në këtë çështje juridike kontestuese nga ku ka rrjedhur se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar.

Sipas kontratës së punës, paga është përcaktuar sipas gradës 11 dhe ulja nën këtë gradë është në kundërshtim me dispozitat e kontratës dhe të ligjit. Kërkesa e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik drejtuar kryetarit të Bordit të drejtorëve të të paditurit, sipas të cilës rekomandohet që niveli i përgjithshëm i shpenzimeve për personelin në raport me të hyrat e përgjithshme të të paditurit për vitin 2012, duhet të jetë jo më

shumë se 20%, nuk mund të jetë bazë për uljen e pagës së paditëses pasi që në rekomandimin e Ministrisë nuk janë precizuar se cilat shpenzime operative, e as që theksohet ulja e pagave, prandaj e paditura është dashur ta paraqiste një plan të detajuar operativ lidhur me uljen e shpenzimeve duke i precizuar ato, por një provë e tillë nga ana e të paditurës nuk është paraqitur, për çfarë arsye pretendimet ankimore janë të pabazuara.

Gjykata e Apelit vlerëson se nuk ka prova se i padituri Telekom i Kosovës sh.a. ka bërë ndërhyrje në aktet normative të tij lidhur me zvogëlimin e gradave, prandaj nuk mund të bëhet kjo me një vendim të drejtorit menaxhues. Gjykata e shkallës së parë drejtë ka aplikuar të drejtën materiale duke ju referuar në arsyetim të aktgjykimit nenit 11.1.8, të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës, në të cilin nen ndër të tjera thuhet se *“Kontrata e punës përmban ... lartësinë e pagës bazë”*. Në këtë rast punëdhënësi dhe punëmarrësi me kontratë me vullnetin e tyre të plotë dhe të lirë kanë përcaktuar përveç tjerave edhe lartësinë e pagës e cila duhet të përmbushet nga punëdhënësi.

Përkitazi me lartësinë e aprovuar të kërkesëpadisë në mes të gradës 11 dhe 10 Gjykata e shkallës së parë në cilësinë e provës materiale ka nxjerrë ekspertizën financiare të datës 16.03.2018, të punuar nga eksperti financiar A.B, me të cilën e ka vërtetuar lartësinë e diferencës së të ardhurave që do ta realizonte paditëses në mes të gradës 11 dhe 10 sikurse të mos i ishte zbritur me vendim të kundërligjshëm.

Lidhur me pretendimin ankimor të të paditurës se ekspertiza financiare e ekspertit financiar A.B është e pasaktë, ky pretendim është i pa bazuar, pasi që në procesverbalin e seancës gjyqësore të mbajtur në Gjykatë me datë 08.05.2018 ndër të tjera thuhet se *“... I autorizuari i të paditës nuk ka pyetje për ekspertin...”*.

Në këtë mënyrë gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike sa i përket lartësisë së të ardhurave personale të paditëses në mes gradës 11 dhe 10 dhe atë për ndryshimin e pagës, kontributit dhe të trustit.

Sa i përket vendosjes nga gjykata e shkallës së parë lidhur me shpenzimet e procedurës, i njëjti është i bazuar në nenin 449, dhe nenin 452.2 të Ligjit nr.3/L-006 për Procedurën Kontestimore.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të Ligjit nr.3/L-006 për Procedurën Kontestimore, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**

**A.C.nr.3910/2018 datë 15.02.2021**

**Kryetari i kolegjit - Gjyqtari,  
Bujar Muzaqi**